

Këshillit shkencor-mësimor te FSHMN-së

Në Prishtinë

Në bazë të konkursit të shpallur më 13 tetor 2005, në të përditëshmen “Zeri”, jemi zgjedhur anëtarë të Komisionit profesional (recenzues) për zgjedhjen e personelit akademik (mësimdhenes në gjuhën shqipe) te Fakultetit te Shkencave Matematike-Natyrore të UP-së.

Në mbledhjen e VII –të Këshillit të Fakultetit të mbajtur më 24.11.2005 jemi caktuar në Komision recenzues

1. Dr Halil Turku, prof. ordinar, i FSHMN-së
2. Dr Muharrem Berisha, prof. ordinar i FSHMN-së
3. Dr Emrush Gashi, prof ordina i FSHMN-së

Në Konkursin e shpallur për lëndët :1) Elementet te Algjebres , 2) Matematika Elementare I dhe 3) Matematika Elementar II ne seksionin e Matematikës te FSHMN-së.

Në konkurs është paraqitur vetëm një kandidatë, Dr. sc. Marjan Dema, prof inordinar.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur Komisioni paraqet këtë

RAPORT

I. Shenime biografike.

Dr. sc. Marjan Dema është i lindur më 27.05.1957 në fshatin Stupë, KK i Klinës. Shkollën fillore e ka kryer më sukses të shkëlqyeshëm në Budisalc, KK I Klinës. Ka mbaruar gjimnazin Matematikor më sukses të shkëlqyeshëm në Prishtinë në vitin 1976. Pastaj

i rexhistroi studimet në seksionin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore në Prishtinë të cilat i mbaroi në afat

record në vitin 1980 më notë mesatare 9.33. Për suksesin e treguar gjatë studimeve është dekoruar më diplomën “Student i Dalluar”, nga Pleqësia e Universitetit të Kosovës në Prishtinë.

Në vitin 1975 ka marrë pjesë në garat e matematicientëve të Gjinnazeve Matematikore nga të gjitha viset e ish Jugosllavisë të mbajtura në Zagreb. Si student mori pjesë cdo vit në garat internacionale të matematicientëve ISTAM, si përfaqësues i FSHMN, të mbajtura në Beograd.

Në vazhdim i rexhistroi studimet e shkallës së tretë në Prishtinë të cilat i përfundoi në vitin 1984 me notë mesatare 9.00 duke mbrojtur më sukses temën e magjistraturës me titull “ Disa veqori të interpolimit të funksioneve analitike në hapësirat të Hilbertit”.

Në vitin 1983/84 qendroi për specialim në Universitetin Shtetror të Vilniusit në Lituani, ku ka punuar në teorinë e Interpolimit të shumfishtë.

Në vitin 1987 më sukses e mbrojti temën e doktoraturës më titull “Interpolimi i shumëfishtë në hapësirat H^p pa konditën e Karlesonit”.

Në vitin 2001 nga World Education Services në New York të SHBA ka fituar titullin Ph.D. për Matematikë.

Në vitin 1978-1981 ka punuar si profesor i Matematikës në Gjinnazin “ Ivo Lolla Ribar” të Prishtinës.

Në vitin 1980 ka qenë i angazhuar si asistent bashkëpunëtor , ndërsa në vitin 1981 është pranuar asistent në Seksionin e Matematikës të FSHMN ku ka mbajtur ushtrime nga lëndet që vijojnë:

- Teoria e funksioneve më variabel kompleks,
- Topologji,
- Matematika I dhe II në seksionin e Ndertimtarisë,
- Matematikë në seksionin e Arqitekturës, të Fakultetit të Ndertimtarisë dhe Arqitekturës,
- Matematikën III në Fakultetin e Maqinerisë .

Në vitin 1984 është zgjedhur ligjerues për lëndën e Gjeometrisë Deskriptive . Në të njëjtën lëndë, në vitin 1987 është zgjedhur në thirrjen e docentit, të cilën më sukses e ka ligjeruar deri në vitin 1997.

Në vitin 1994 është zgjedhur në thirrjen e profesorit inordinar për lëndën e Gjeometrisë Deskriptive .

Në vitin 1994 është zgjedhur në të njëjtën thirrje për lëndën Matematika për ekonomistë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë. Gjatë viteve shkollore 1976/77 ka qenë prodekan për qeshtje materiale në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Në Fakultetin Ekonomik punoi deri në vitin 2001.

Në vitet shkollore 1987-1989 ka punuar si profesor në SHLP “Skenderbeu” ku ka mbajtur lëndën e Algjebrës Lineare.

Nga viti 1997 deri ne vitin 1999 ka qenë professor i lëndës së Matematikës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës në Tetovë.

Në vitin shkollor 1997/98 ka mbajtur mësim në shkallën e tretë të Fakultetit të Xehtarisë dhe Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës, ku ka ligjeruar lëndën Teoria e Programimit Linear.

Në vitet shkollore 2002-2005 punoi professor në Kolexhin Amerikan “Midwestern Baptist College “ në Pontiac, SHBA.ku ka majtur këto lëndë:

- Matematike Elementare
- Algjeber I

Është njohes I mirë i paketit të Microsoft Ofisit (Microsoft Word, Microsoft Excel, Microsoft Acces dhe Microsoft Power Point) të cilat mësimet I kam arritur në Schoolcraft College në Livonia, Michigan, SHBA.

I flet dy gjuhë botërore: Anglisht dhe Gjermanisht.

PUBLIKIMET

II. Publikimet Shencore

1. Dr Marjan Dema. "On a Problem of Multiple Interpolation in H^p Spaces." – Liet. Matem. Rink., Vilnius, Lithuania. 1985
2. Dr Marjan Dema. "Një problem mbi interpolimin në Hapësirat H^p " - Buletini I FSHMN, Prishtinë 1995
3. Dr Marjan Dema. "Interpolimi I shumëfishtë mbi hapësirat H^p ". – Buletini I FSHMN, Prishtinë 1995
4. Dr Marjan Dema. "Mbi interpolimin e shumëfishtë më peshë në klasat $H^p(p \geq 1)$ ". Kerkime, Prishtinë 1997
5. Marjan Dema. "Disa veqori të interpolimit të funksioneve analitike në hapësirat të Hilbertit", punimi I magjistraturës, Prishtinë 1984
6. Marjan Dema. "Interpolimi I shumëfishtë në hapësirat H^p pa konditën e Karlesonit., punim I disertacionit të doktoratës, Prishtinë 1987.

III. Pjesëmarrja në Simpozium:

Dema M. (M-4, 49). Zgjidhja e një problemi të interpolimit të shumëfishtë në hapësirat $H^p(p \geq 1)$ pa konditën e Kalesonit. Kongresi I VIII-të I Matematikentëve, Fizikentëve, dhe Astronomëve të Jugosllavisë, Prishtinë 23-27 shtator, 1985

Tekste Universitare dhe shkollore:

1. Dr Marjan Dema, Probleme të zgjidhura nga Gjeometria Deskriptive, Prishtinë 1990
2. Dr Marjan Dema, Dr Fuat Rizvanolli. Matematika për ekonomistët, Prishtinë 1995
3. Dr Marjan Dema, Dr Nexhat Muhaxheri, Testet për provimin klasifikues, Prishtinë, 1997
4. Dr Marjan Dema, Dr Muharrem Berisha, Matematika për klasën e II gjimnaz, Prishtinë 1988
5. Dr Marjan Dema, Dr Halil Turku, Dr Muharrem Berisha, Matematika për klasën e III gjimnaz, Prishtinë. 1990

PERFUNDIM:

Ne bazë të dokumentacionit që ka pasur në dispozicion, komisioni rrecenzues i propozon Këshillit shencor-mësimor të Fakultetit të shkencave matematike-natyrore në Prishtinë që Dr. sc. Marjan Demaj të zgjedhet në thirrjen e profesorit të asocuar, për

lëndet Elementet të Algjebrës, Matematika elementare I dhe Matematika elementareII,
në departamentin e Matematikës të fakultetit të shkencave matematike-natyrore në
Prishtinë.

Data:
29.12.2005

Komisioni recenzues:
Dr. sc. Halil Turku, prof. ordinar

Dr. sc. Muharrem Berisha, prof. ordinar

Dr.sc. Emrush Gashi, prof ordinar